



Konferenca e Tretë Ndërkombëtare e Institutit Kombëtar të Fizikës

Në vijim të traditës së krijuar, Instituti Kombëtar i Fizikës (IKF, www.ikf-akad.al), me mbështetjen e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, organizon Konferencën e tij të Tretë në datat 2-3 qershor 2025.

Ky njoftim është njëkohësisht edhe ftesë për të gjithë fizikanët e interesuar që të marrin pjesë në këtë aktivitet shkencor. Konferenca do të mbahet në format të përzier, me pjesëmarrje fizike dhe online. Regjistrimi është pa pagesë. Gjuhët e komunikimit do të jenë anglisht dhe shqip.

IKF synon promovimin e dijeve bashkëkohore dhe të ekselencës në fushën e fizikës në të gjithë hapësirën ku punojnë fizikanët shqiptarë, brenda dhe jashtë trojeve tona.

Qëllimi i konferencës është përhapja e rezultateve të kërkimit shkencor e të arritjeve më bashkëkohore në fizikë, përfshirë këtu dhe mësimdhënien; konsolidimi i bashkë-punimit mes fizikanëve shqiptarë e joshqiptarë, si dhe zgjerimi i IKF me anëtarë të rinj. Meqenëse 2025 është shpallur viti ndërkombëtar i teknologjisë kuantike, konferenca do të ketë në fokusin e saj arritjet madhore në këtë fushë qendrore të fizikës.

Konferenca do të ketë vend për referime nga fizikanë të ftuar, shqiptarë ose të huaj.

Konferenca mbahet në Tiranë, në mjediset e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Për regjistrimin, drejtojuni faqes <https://ikf-akad.al/konferenca/> (email: konferencaikf@ikf-akad.al). Afati i regjistrimit është data 4 maj 2025.

Bordi Shkencor

Bashkëkryetarë

- Rexhep Meidani - Akademia e Shkencave e Shqipërisë
- Florian Vila - Akademia e Shkencave e Shqipërisë



Anëtarë

- Ardian Gojani - Secopta Analytics, Teltow, Gjermani
- Halil Sykja - Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Hiqmet Kamberaj - Fakulteti i Inxhinierisë, Universiteti Ballkanik Ndërkombëtar, Maqedonia e Veriut
- Mimoza Hafizi - Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Orion Çiftja - Universiteti Prairie View A&M, Teksas, ShBA
- Toni Shiroka - Universiteti ETH Zürich dhe Instituti Paul Scherrer, Zvicër

Bordi Organizues

- Fatos Ylli - Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Gerti Xhixha - Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Mimoza Hafizi - Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Neki Frashëri - Akademia e Shkencave e Shqipërisë
- Olta Çakaj - Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Partizan Malkaj - Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, Universiteti Politeknik i Tiranës, Shqipëri
- Rudina Osmanaj - Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, Shqipëri

Sekretaria

Olta Çakaj - Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
Koordinatore e IKF
oltacakaj@ikf-akad.al